



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-30772/23 datë: 21.11.2023



Npi – 01/440 datë: 24.11.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 24.11.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -XI- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 24.11.2023 (e premte) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Drejtori i Shëndetësisë, z.Muharrem Asllani, nga zyra për informim znj.Vlora Hyseni dhe praktikantët znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin prej 5 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 30.10.2023.
2. Diskutim dhe raportim nga përfaqësuesi i ZKKK-së,
3. Diskutim për Propozim-Vendimin për Normat Tatimore për vitin 2024,
4. Diskutim për raportin 9 mujor Buxhetor i Komunës së Shitmes për Janar-Shtator 2023,
5. Diskutim për Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vjt të pronës Komunale, (Për diskutim publik)
6. Diskutim për Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Laureatëve të vitit në sport, (Diskutim Publik)
7. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës dhe orarit të mbledhjeve të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
8. **Të ndryshme (Pikë Shtesë)**

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, tani po e shoh se është dashur me e vendos edhe pikën e 8 të ndryshme.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, pajtohem që duhet me shtu edhe pikën të ndryshme, sepse e kemi drejtorin e shëndetësisë prezent në mbledhje dhe kemi mundësi me i bërë disa pyetje, por fillimisht drejtorit i uroj punë të mbarë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë mendoj se sot meqenëse është dita e parë nuk duhet ta ngushtojmë drejtorin me pyetje sepse sa po e ka marrë punën, dhe ne do të kemi mundësi tjera në vazhdim që ti bëjmë pyetje. Meqenëse diskutime tjera nuk ka për rendin e ditës po e qes në votim rendin e ditës me pikën shtesë (Të ndryshme).

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi rendin e ditës me pikën e 8 shtesë: (Të ndryshme).**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 30.10.2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 30.10.2023.**

Pika 2

Diskutim dhe raportim nga përfaqësuesi i ZKKK-së

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Fillimisht ju njoftoj se kemi caktuar një takim pune me Kryetarin ku kemi qenë 4 anëtarë të KPK-së, kemi pritë 50 minuta dhe Kryetari nuk ka ardhur. Po ashtu ju njoftoj se në Zyrën për Komunitete dhe Kthim është zgjedhur znj.Elfe Shabani. E hapi diskutimin për këtë pikë nëse Muhameti ka ndonjë informatë më shumë.

z.Muhamet Mehmeti; Po, Elfeti më ka njoftuar se është autorizuar për të punuar dhe për nënshkrimin e disa kërkesave që është dashur me u nënshkru, unë mendoj se është bërë mirë. Kanë qenë 7 kërkesa të cilat janë me vlerë 2940 euro, që kanë të bëjnë me fushën e shëndetësisë dhe renovim për Komunitetin pakicë. Nuk kemi informata të tjera. Elfeti punon edhe në zyrën pritëse. Është mirë që buxheti i zyrës është shpenzuar në tërësi tani është 0 dhe kjo është mirë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Propozoj që të bëjmë një propozim ose rekomandim, për Elfetin që të punoj vetëm në zyrën e ZKKK-së.

z.Besnik Seferi; Fatmirsisht e kemi drejtorin këtu dhe shpresat i kemi te ky drejtor. I kam shterrur të gjitha mundësit dhe kërkesat janë shku në vesh të shurdhër. Në seancën e kaluar unë defenitivisht do të dalë publikisht edhe do të jam në gjendje të japë edhe dorëheqje. Dhe kjo para e Komitetit është falë për neve. Unë kam pas takim me Kryetarin është marrë me një jo seriozitet ndaj këtij Komiteti. Unë personalisht nuk jam pjesë e këtij Komiteti në qofse nuk ndërmmirret diçka. Unë nuk po e fajsoj zyrën e Informimit por ekzekutivin. Ka mbi 200 kërkues që kanë shku te zyra e ZKK-së dhe që nuk kanë mujt me kry shërbime rreth 15 kërkesa janë vetëm për shëndetësi. Së paku le të jetë një administrator në zyrën e ZKK-së që të funksionojë kjo zyre për shërbime.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Dikush duhet të jetë në zyrën e ZKK-së, mendoj se aty duhet të jetë Elfete Shabani dhe ti kryej detyrat në atë zyre.

z.Muhamet Mehmeti; Unë kam biseduar me Elfeten. Buxheti i Komunës edhe 3 javë mbyllet dhe kërkesa nuk pranohen. Unë po mendoj që na duhet edhe një takim me Kryetarin, një rekomandim direkt duhet të ja bëjmë Kryetarit.

z.Arton Demiri; Pajtohem çka thanë parafolësit, kamë respekt për Elfeten por ajo nuk mundet me mbajtë këtë punë. Ka plot zyrtarë të tjerë që mundën. Ne kemi qenë te Kryetari por Kryetari nuk ka interes me ju ndihmu Komunitetit.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht i rekomandon Kryetarit të Komunës së Shtimes, që znj.Elfe Shabani, të ketë përgjegjësi që të përfaqësojë vetëm Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe mos të ketë detyra të tjera të punës, si dhe shefi i zyrës të trajtohet më me seriozitet.**

Pika 3

Diskutim për Propozim-Vendimin për Normat Tatimore për vitin 2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Kjo bëhet vit për vit, lidhur me përcaktimin e vlerës së pronës. Sa i përket për lirimin e pronave, ne nuk jemi për këtë, mendojë që si draft-propozim të shkojë ashtu si është në Kuvend.

***Komiteti për Komunitete unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Normave Tatimore të Komunës së Shtimes për vitin 2024.**

Pika 4

Diskutim për raportin 9 muhor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Shtator 2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Kemi një rritje të investimeve kapitale dhe mendojë se është bërë një gjithëpërfshirje e shpërndarjes së projekteve nëpër vendbanimet e komunës duke përfshirë edhe komunitetin pakicë. Edhe drejtoria e arsimit ka premtuar që do të bëjë ç'mos për gjithëpërfshirjen e Komuniteteve. Megjithatë unë kisha me futë në raport që disa prej kanalizimeve dhe trotuareve me i rregulluar që me ja u lehtësu qytetarëve jetën.

Komiteti për Komunitete, me 2 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim" nuk e miratoi Rekomandimin për Kuvendin, që ka të bëjë me Raportin 9 Muhor Buxhetor i Komunës së Shtimes Janar-Shtator 2023.

Pika 5

Diskutim për Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vit të pronës Komunale, (Për diskutim publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale për më pak se një vit.**

Pika 6

Diskutim për Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në sport, (Diskutim Publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Kjo është një dreft-rregullore për sport, që e ka një përfaqësues nga KAKRS-ja unë kisha propozuar që në Komision të jetë edhe një anëtarë nga Komiteti për Komunitete, që të përfshihet në grupin punues për hartimin e draft rregullores.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Për shkak që e potencoi Rrezartë Ramadani, se grupi punues veç ka kalu dhe e ka kryer punën ku e ka hartuar draft-rregulloren dhe tani nuk mundet me u përfshi asnjë anëtarë.

*** Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -XI- për vitin 2023, të mbajtur më: 24.11.2023, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregulloren për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Lauratëve të vitit në Sport.**

Pika 7

Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të punës dhe orarit të mbledhjeve të Komitetit për Komunitete për vitin 2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Për shkak që sot janë dy anëtarë të Komitetit në mungesë, unë kisha propozuar që të gjithë anëtarët e Komitetit të përfshihemi në formimin e grupit punues për hartimin e planit të punës.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Edhe unë e kisha përkrahë propozimin që grupi i punës të jetë i përbër prej të gjithë anëtarëve të Komitetit.

znj.Rrezartë Ramadani; Ne nuk kemi nevojë që ta presim Kuvendin që ta bëjmë planin e punës për vitin 2024 për KPK-në, prandaj ne mund ta hartojmë planin e punës pavarësisht Kuvendit.

*** Komiteti për Komunitete unanimisht vendosi që për hartimin e Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, të përfshihen të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete, si vijon: z.Bajram Ilazi, z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, znj.Shkurte Behluli dhe z.Arton Demiri.**

Pika 8

Të ndryshme (Pikë shtesë)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; I kamë dy nënpika, unë kisha kërkuar me dërgu një kërkesë për buxhet për një puntori dy ditore që të përpilohet plani i punës, sepse në dhjetor e kemi takimin e fundit për këtë vit, dhe kisha propozu që këtë kërkesë me paraqitë te Kryetari i Komunës.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Edhe unë jamë i pajtimit, por te pika shtesë “të ndryshme” ne duhet të flasim vetëm për një pikë.


z.Muhamet Mehmeti; Vetëm desha me cek se ka ardhur një kërkesë nga qytetarët për një rrugë “Enver Gashi” në Shtime.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Janë të dyja pikat shumë të rëndësishme por mendoj që duhet vetëm njëra pikë me u diskutuar.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht i rekomandon Kryesuesit të Komitetit Komunal Veprues (KKV) që në procesin e hartimit të Planit Veprues të (KKV) të përfshihen edhe pjestarët e Komunitetit pakicë në komunën e Shtimes.**

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:47h.

Procesmbajtës
Valmira Hoxha



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

